

**LIGJI Nr. 04/L-064
PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR FORENZIKË

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj rregullon themelimin, misionin, organizimin, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. AKF-ja është institucioni përgjegjës për ofrimin e paanshëm, të analizave objektive shkencore forenzike.
2. AKF-ja i kryen veprimet me urdhër të gjykatës, prokurorisë apo me kërkesë të agjencive të zbatimit të ligjit.
3. AKF-ja ofron shërbime edhe për organet shtetërore sipas ligjit përkatës në fuqi.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **MPB** - Ministria e Punëve të Brendshme;
- 1.2. **Ministri** – Ministër i Punëve të Brendshme;
- 1.3. **AKF** – Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
- 1.4. **Policia** - Policia e Kosovës;
- 1.5. **Agjencitë për zbatim të ligjit** - të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të themeluara me ligj;
- 1.6. **Ekspert** – personeli i Agjencisë së Forenzikës që kryen hulumtim, hetim, gjurmim, vlerësim apo studim të provuar nga personeli i specializuar i AKF-së;

1.7. **Personel i specializuar shkencor** - punonjësi i specializuar teknik dhe menaxhues që kryejnë, udhëheqin apo verifikojnë ekspertimet kriminalistike, si dhe asistojnë në shikimin apo rikonstruimin e vendit të ngjarjes;

1.8. **Personel mbështetës** - punonjësi administrativ të personelit, logjistikës, prokurimit, financave dhe mirëmbajtësve teknik;

1.9. **Personel me kohë të pjesshme dhe me kontratë** – personeli i jashtëm të kontraktuar nga AKF për konsulencë apo ekspertizë;

1.10. **Shkenca e Forenzikës** - aplikimi i shkencave (kimi, biologji, fizikë, matematikë, inxhinieri, makineri, kriminalistikë, etj.) për gjetjen, identifikimin, individualizimin, analizimin dhe vlerësimin e dëshmive fizike (provave materiale) për çështje ligjore penale dhe civile;

1.11. **Ekspertizë** - hulumtimi, hetimi, gjurmimi, vlerësimi apo studimi i provuar, përfshirë edhe raportet nga këto aktivitete, konstatimet dhe rezultatet që kërkojnë njohuri specifike dhe të cilat kryhen nga ekspertë për të vërtetuar dhe dhënë mendimin mbi faktet e caktuara;

1.12. **Urdhëresë për ekspertim** - urdhëresa e gjyqtarit apo prokurorit për kryerjen e ekspertizës;

1.13. **Kërkesë për ekspertim** - kërkesa e agjencive për zbatimin e ligjit apo institucioneve tjera shtetërore për kryerjen e shërbimeve;

1.14. **Formulari/kërkesa** –formulari i AKF-së për ekspertim;

1.15. **Dëshmi** - dokumenti, prova që dëshmon ndonjë fakt të caktuar;

1.16. **Provë** – vërtetimi i të dhënave që duam të njohim a ta studiojmë më thellë: eksperiment që bëhet për të marrë të dhëna për diçka, për të kontrolluar saktësinë e diçkaje, veprim paraprak që bëhet për të kontrolluar apo vërtetuar saktësinë e një lloji, një gjëje, a mase të diçkaje, duke u mbështetur në fakte a dëshmi. Prova është e dhënë që vërteton ose mohon diçka;

1.17. **Të dhënat relevante** - baza e të dhënave të cilat mbahen nga AKF-ja;

1.18. **Zinxhiri i ruajtjes** - zinxhiri i ruajtjes dhe evidentimit të dëshmisë fizike në rastin e pranim-dorëzimit të dëshmisë në AKF;

1.19. **Këshilli për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim** - këshilli në nivel të AKF-së në përbërje të kryeshefit ekzekutiv, drejtorëve të departamenteve dhe menaxherit të cilësisë;

1.20. **Procedurat e brendshme teknike** - procedurat e brendshme shkencore të AKF-së.

Neni 4

Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë

1. Agjencia e Kosovës për Forenzikë themelohet si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2. Agjencia e Kosovës për Forenzikë është person juridik.

3. Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i garantohet e drejta për veprimtari objektive dhe të paanshme.

4. Selia kryesore e AKF-së është në regjionin e Prishtinës.

Neni 5 Misioni

Misioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së saj, të ofroj shërbime forenzike cilësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 6 Parimet

1. Punonjësit e AKF-së duhet të respektojnë Kodin e etikës së AKF-së dhe parimet që parashihen me Kodin e mirësjelljes për nëpunësit civil.
2. Punonjësit e AKF-së, në përmbushje të detyrave të tyre, do të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 7 Simbolet

AKF ka stemën e cila propozohet nga Kryeshefi i AKF-së dhe miratohet nga ministri.

Neni 8 Kartela e identifikimit

1. Punonjësit e AKF-së janë të pajisur me kartelë identifikimi që shërben si autorizim për veprim në AKF-ë.
2. Forma, pajisja dhe mënyra e përdorimit të dokumentit të identifikimit rregullohet me një akt normativ që nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

Neni 9 Buxheti

AKF-ja është zë i veçantë buxhetor në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Buxheti i AKF-së duhet të shqyrtohet dhe miratohet në procesin e rregullt buxhetor, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 10 Akreditimi

1. Laboratorët e AKF-së duhet të akreditohen dhe mirëmbahen sipas standardeve ndërkombëtare.
2. Procedurat për akreditim konform standardeve ndërkombëtare dhe afatet për akreditim do të rregullohen me udhëzim administrativ nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

Neni 11 Ministri

1. Kryeshefi i AKF-së i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së-së. Kryeshefi i AKF-së bashkëpunon me ministrin dhe i ofron atij informatat dhe raportet e nevojshme për administrimin dhe menaxhimin e AKF-së.

2. Në lidhshmëri me paragrafin 1. të këtij neni, informata që ka të bëjë me çështje hetimore apo ndonjë ekspertizë, mund të ofrohet vetëm me urdhër të gjykatës kompetente apo prokurorisë.

3. Ministri mund të kërkojë raporte, informacione dhe dokumente të tjera, që lidhen me detyrat e AKF-së lidhur me administrimin dhe menaxhimin e AKF-së, duke mos ndërhyrë në veprimtarinë e AKF-së siç është paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONET

Neni 12 Struktura organizative e AKF-së

Struktura e brendshme organizative e AKF-së propozohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së dhe miratohet nga ministri.

Neni 13 Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së është autoriteti ekzekutiv apolitik në kuadër të AKF-së dhe autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i AKF-së.

2. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së është përgjegjës për:

2.1. administrimin dhe menaxhimin e gjithëmbarshtë të AKF-së;

2.2. organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të AKF-së;

2.3. menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar AKF-së.

Neni 14 Kriteret për emërim dhe përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së

1. Kriteret për emërim të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së janë:

1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë diplomuar në një nga universitetet e pranura dhe akredituara në fushat që kanë të bëjnë me shkencën e forenzikës;

1.3. të ketë të paktën tri (3) vjet përvojë pune në pozitë menaxheriale në fushat që kanë të bëjnë me shkencën e forenzikës;

1.4. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;

1.5. të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rënda disiplinore ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së AKF-së, brenda dhjetë (10) viteve të fundit, gjatë të cilave ka punuar në institucione shtetërore;

1.6. të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo siç parashihet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

2. Ministri themelon një komision të veçantë për përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv i cili duhet të jetë pesë (5) anëtarësh.

3. Komisioni nga paragrafi 2. i këtij neni, pas përzgjedhjes i propozon ministrit tre (3) kandidatë për Kryeshef Ekzekutiv të AKF-së. Ministri e emëron Kryeshefin Ekzekutiv bazuar në kandidaturat e propozuar nga komisioni.

4. Përbërja e komisionit si dhe procedura e përzgjedhjes rregullohet me akt nënligjor që nxirret nga ministri.

Neni 15

Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së emërohet për një periudhë kohore prej pesë (5) vjetësh, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjetësh.

2. Nëse Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së i përfundon mandati në vitet kalendarike të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tij në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për dy (2) vjet.

Neni 16

Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së

1. Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së lirohet apo shkarkohet nga detyra nga ministri për njërin nga arsyet e mëposhtme:

1.1. është dënuar për vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

1.2. arrin moshën për pension;

1.3. jep dorëheqje;

1.4. për shkak të pamundësisë për ushtrimin e detyrës për një periudhë kohore më të gjatë se gjashtë (6) muaj;

2. Ministri i shqipton Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së, masat disiplinore vërejtje me shkrim apo shkarkim nga detyra, për njërin nga arsyet e mëposhtme:

2.1. kryerja e një shkelje të rëndë të disiplinës, siç është e paraparë në rregulloren e disiplinës;

2.2. pas një vlerësimi negativ të dokumentuar të punës, për ndonjë shkelje të rregullave të integritetit apo mosrespektim i akteve nënligjore për disiplinën dhe personelin;

2.3. ka shfaqur mungesë të theksuar angazhimi, të argumentuar, në përmbushjen e objektivave strategjike dhe në kryerjen e detyrave sipas nenit 13 të këtij ligji.

3. Kur ekziston dyshim i arsyeshëm për të besuar se Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së, ka kryer vepër penale apo për ndonjërin nga arsyet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni, ministri mund të suspendojë menjëherë Kryeshefin Ekzekutiv të AKF-së.

4. Në rastet e lirit, shkarkimit apo suspendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së, ministri menjëherë emëron njërin nga drejtorët e departamenteve të AKF-së, si ushtrues detyrë të Kryeshefit Ekzekutiv deri në përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv të AKF-së, jo më gjatë se gjashtë (6) muaj.

Neni 17

Gradat dhe funksionet e punonjësve të AKF-së

1. Personeli i AKF-së ndahet në tri (3) kategori të gradimit dhe funksioneve:

1.1. personeli i specializuar- shkencor;

1.2. personeli mbështetës;

1.3. pozitë ekzekutive.

2. Procedurat dhe kushtet e gradimit do të rregullohen me një udhëzim administrativ që nxirret nga ministri me propozimin e Kryeshefit të AKF-së.

KREU III KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AKF-së

Neni 18 Veprimtaria e AKF-së

1. AKF kryen ekspertime të dëshmimeve, sipas kodit të procedurës penale dhe legjislacionit në fuqi.

2. AKF dëshmon në gjykatë apo prokurori ashtu siç është paraparë në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionit në fuqi.

3. AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale del në vend të ngjarjes për asistencë në shikimin e vendit të ngjarjes.

4. AKF-ja bazuar në kodin e procedurës penale do të asistojë në rikonstruimin e vendit të ngjarjes.

5. AKF-ja përkrah ose ndihmon në hetimin e incidenteve në bazë të kërkesës së institucioneve shtetërore.

6. AKF në sisteme manuale apo sisteme të digjitalizuara, mban dhe mirëmban të dhëna relevante për qëllime krahasimore.

7. Administrimi i të dhënave relevante dhe shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione tjera brenda vendit si dhe aspekte tjera lidhur me të dhënat e personave do të rregullohen me udhëzim administrativ nga Kryeshefi i AKF-së, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8. Shkëmbimi i të dhënave të AKF-së me vendet tjera do të rregullohet përmes marrëveshjes ndërkombëtare në mes të MPB-së dhe autoriteteve të huaja shtetërore, apo organizatave tjera të huaja.

9. AKF do të mbajë koleksion të armëve për qëllim të kryerjes së veprimtarisë së saj. Koleksioni i armëve do mbahet në përputhshmëri me Ligjin për Armët.

10. AKF përmes këshillit për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim autorizon punonjësit shkencor për fillim dhe vazhdim të kryerjeve të ekspertimeve. Ky këshill merr vendime për cilësinë e shërbimeve shkencore në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e AKF-së.

11. Procedura dhe kushtet e funksionimit të këshillit për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim do të rregullohen me një udhëzim administrativ që do të nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

12. AKF do të kryejë hulumtime shkencore forenzike.

13. Procedurat dhe kushtet e hulumtimit, trajnimit dhe bashkëpunimit në fushën e forenzikës do të rregullohen me një udhëzim administrativ i cili do të nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 19

Administrimi i provave

1. Dëshmitë, respektivisht lëndët të cilat dërgohen për ekspertim në AKF, duhet të jenë të kompletuara. Lënda e kompletuar duhet të përmbajë urdhëresën për ekspertim, formularin/kërkesën e plotësuar të AKF-së për ekspertim, dëshmitë fizike që duhet ekzaminuar dhe zinxhirin e ruajtjes.
2. AKF është e obliguar që të kryejë me kohë ekspertizën e dëshmisë dhe krahas dëshmisë, dosjes t'ia bashkëngjijë raportin gjithëpërfshirës, në të cilin duhet të jepet mendimi profesional lidhur me ekspertizën e kryer.
3. AKF në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe agjencitë e tjera për zbatimin e ligjit do të përcaktojë procedurën për marrjen, dokumentimin, evidentimin, ruajtjen dhe transportimin e provave materiale.
4. Punonjësit e AKF-së janë të obliguar që ta ruajnë fshehtësinë dhe sekretin lidhur me ekspertizën e kryer. Personave të paautorizuar nuk u lejohej të nxjerrin në shesh, shpallin-publikojnë raportet, dokumentet apo veprimet tjera lidhur me ekspertimin e kryer, e as të japin deklaratë për opinion pa lejen e autoriteteve kompetente.

KREU IV

TE DREJTAT E PERSONELIT DHE DISIPLINA

Neni 20

Të drejtat e punonjësve të AKF-së

1. Punonjësit e AKF-së kanë të drejtë për punësim të përhershëm deri në plotësimin e kushteve për pensionim, me përjashtim të individëve të cilët janë të punësuar në bazë të kontratës për shërbim për një periudhë fikse, si dhe atyre që shkarkohen me arsye, në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. Paga bazë, rritjet në pagë, shtesat dhe dobitë e tjera përfshirë edhe skemën e pensionit dhe sigurimin për punonjësit e AKF-së do të përcaktohen me udhëzim administrativ nga ministri, ku do të përfshijnë shtesat por nuk kufizohen në pagesa për rrezikshmërinë në punë, pagesa për punë jashtë orarit dhe gjatë festave, pagesa për shujtë ditore, pagesa për veshmbathje, pagesa për detyrat speciale dhe shkathtësitë speciale.
3. Punonjësit e AKF-së të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i ndonjë veprimi disiplinor, përfitojnë si shpërblim 50% të pagës së rregullt mujore dhe atë vetëm një herë në vit.
4. Në rast të vdekjes në detyrë apo nëse një punonjës i AKF-së është vrarë për shkak të ushtrimit të detyrave të tij në kuadër të AKF-së, ministria do t'i paguajë familjes së punonjësit të ndjerë apo trashëgimtarit(ve) ligjor të tij pagën mujore të punonjësit të AKF-së, për një periudhë kohore prej një (1) viti nga vdekja e punonjësit të AKF-së.
5. Procedura, kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e AKF-së rregullohen me udhëzim administrativ nxjerrë nga Kryeshefi i AKF-se, që përfshin por nuk do të kufizohet në ngritjen në karrierë, trajnimin dhe konfliktin e interesit.
6. Punonjësit e AKF-së nuk kanë të drejtë greve apo çdo veprim tjetër që pengon apo ndërhyjnë në ushtrimin e veprimtarisë së AKF-së.

7. Punonjësit e AKF-së nuk duhet të shprehin qëndrime apo të ndërmarrin aktivitete që cenojnë natyrën e depolitizuar të AKF-së.

Neni 21 Pushimet e punës

Pushimet e punës të punonjësve të AKF-së rregullohen me një udhëzim administrativ që nxirret nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 22 Disiplina në AKF

Masat, shkeljet disiplinore, suspendimi si dhe procedura disiplinore për punonjësit e AKF-së, rregullohen me udhëzim administrativ nga ministri.

KREU V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Për zbatimin e këtij ligji, ministri do të miraton aktet nënligjore për të përcaktuar:

- 1.1. stemën identifikuese të AKF-së;
- 1.2. strukturën organizative të AKF-së;
- 1.3. procedurën e vlerësimit për punonjësit e AKF-së;
- 1.4. përcaktimin e pagës bazë, rritjet në pagë, shtesat dhe dobitë tjera për punonjësit e AKF-së;
- 1.5. procedurën dhe kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e AKF-së;
- 1.6. procedurën për shkeljet disiplinore, suspendimin si dhe procedurën disiplinore për punonjësit e AKF-së;
- 1.7. procedurat dhe kushtet e gradimit dhe pozitave në kuadër të AKF-së.

2 Për zbatimin e këtij ligji, Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së, do të miraton aktet nënligjore për:

- 2.1. formën, pajisjen dhe mënyrën e përdorimit të dokumentit të identifikimit;
- 2.2. procedurat shkencore për akreditim konform standardeve ndërkombëtare dhe afatet për akreditim;
- 2.3. procedurën për administrimin e të dhënave relevante dhe shkëmbimi i tyre me agjenci apo institucione tjera brenda vendit si dhe aspekte tjera lidhur me të dhënat relevante;
- 2.4. procedurën për sigurinë e të dhënave;
- 2.5. procedurën e funksionimit të këshillit për cilësi, kualifikim dhe rikualifikim;
- 2.6. procedurat dhe kushtet e hulumtimit, trajnimit dhe bashkëpunimit në fushën e forenzikës;

2.7. pushimet nga marrëdhënia e punës për punonjësit e AKF-së.

3. Punonjësit e ish-Laboratorit të Forenzikës –Policia e Kosovës që do të vazhdojnë të punojnë në AKF, gëzojnë të drejtën e stazhit të fituar në Policinë e Kosovës.

4. Punonjësit aktual të uniformuar dhe civil të ish-Laboratorit të Forenzikës-Policia e Kosovës kanë të drejtë që përmes një deklarimi vullnetarë të zgjedhin vazhdimin e punës në kuadër të AKF apo të kthehen në kuadër të strukturave të Policisë së Kosovës.

5. Punonjësit aktual të uniformuar të ish-Laboratorit të Forenzikës-Policia e Kosovës gëzojnë të drejtën e kthimit në gradën aktuale në kuadër të Policisë së Kosovës ashtu siç është paraparë në Ligjin për Policinë.

6. Për zbatimin e këtij ligji mund të nxirren edhe akte tjera nënligjore nga Ministri apo Kryeshefi Ekzekutiv i AKF-së.

Neni 24 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me të.

Neni 25 Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-064
14 tetor 2011**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-042-2011, datë 01.11.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**